



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

# Raporti 4-mujor i monitorimit të Programit të Statistikave Zyrtare

(Maj – Gusht 2018)

Në zbatim të Nenit 17, pika 5 të Ligjit nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, Drejtori i Përgjithshëm ka përgjegjësinë për t’i paraqitur Këshillit të Statistikave raporte të shkurtra 4-mujore mbi ecurinë e zbatimit të Programit të Statistikave Zyrtare.

**Sektori i Monitorimit të zbatimit të PSZ-së / Drejtoria e Integritimit Evropian dhe Koordinimit të Projekteve**

INSTAT - Instituti i Statistikave

Tel+(355) 4 2222411  
+(355) 4 2233356  
Fax+(355) 4 2228300

Bul. "Zhan D'Ark", Nr .3  
Tiranë, Shqipëri

[info@instat.gov.al](mailto:info@instat.gov.al)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

## - Fusha prioritare 02: Drejtimi Ekonomik

Kjo fushë prioritare mbulon prodhimin e statistikave financiare të qeverisë, administratës publike dhe statistikave mbi defiçitin dhe borxhin publik.

- Objektivi i kësaj fushe është përpilimi i statistikave financiare të qeverisë sipas manualit të FMN-së të vitit 2014 dhe ESA 2010 në baza 3-mujore dhe vjetore, prodhimi i statistikave të llogarive jo-financiare të administratës publike si dhe përdorimi i një programi të unifikuar i të dhënave të borxhit publik.

Agjencitë statistikore përgjegjëse: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

### Aktivitete statistikore të realizuara

1. Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të Qeverisë
2. Statistikat e Borxhit

### Rezultatet e arrira

Janë raportuar pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisë me përfshirjen e të dhënave të disa njësive ekstra-buxhetore (SH.A Ujësjellës –Kanalizime).

## - Fusha prioritare 04: Performancat Ekonomike dhe Sociale

Kjo fushë prioritare mbulon prodhimin e statistikave cilësore të llogarive vjetore sipas sektorëve, të metodologjisë dhe prodhimit të të dhënave të llogarive financiare, treguesve monetarë, financiarë dhe të llogarive kombëtare vjetore dhe tremujore me metoden e prodhimit. Gjithashtu në këtë fushë përfshihet dhe prodhimi i statistikave të bilancit të pagesave, indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK) si dhe indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumit (IHÇK) në përputhje të plotë me metodologjinë e Eurostatit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- Objektivi i kësaj fushe është zbatimi i plotë i metodologjisë së ESA 2010 në prodhimin e statistikave të llogarive kombëtare si dhe zhvillimi i metodologjisë dhe hartimi i statistikave të normave të interesit sipas kërkesave të Bankës Qëndrore Evropiane.

Agjencitë statistikore përgjegjëse: INSTAT, Banka e Shqipërisë.

#### **Aktivite statistike të realizuara**

1. Agregatët monetarë
2. Të dhëna të bankës qendrore - Bilanci sektorial
3. Të dhëna të bankës qendrore - Paraqitja monetare
4. Të dhëna të bankave paradepozituese - Bilanci sektorial
5. Të dhëna të bankave paradepozituese - Paraqitja monetare
6. Bilanci sektorial i shoqërive të kursim - kreditit
7. Të dhëna të korporatave të tjera depozituese - bilanci sektorial
8. Të dhëna të korporatave të tjera depozituese - paraqitja monetare
9. Paraqitja monetare e korporatave depozituese
10. Bilanci sektorial i institucioneve të tjera financiare
11. Paraqitja monetare e institucioneve të tjera financiare
12. Depozitat e përfshira në paranë e gjerë
13. Depozitate e reja sipas monedhës
14. Depozitat me afat në Lek, Usd dhe Eur, subjektit dhe maturitetit
15. Depozitat sipas qarkut
16. Kredia për ekonominë
17. Huatë e reja sipas monedhës
18. Huatë sipas qëllimit të përdorimit dhe monedhës (fluks dhe stok) dhe sipas aktivitetit ekonomik
19. Huatë sipas qarkut, afatit, subjektit dhe aktivitetit ekonomik



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

20. Kursi i këmbimit
21. Llogarite Kombëtare Vjetore, Produkti i Brendshëm Bruto (PPB) me metodën e prodhimit
22. Llogaritë vjetore, PBB metoda e Shpenzimeve
23. PBB tremujore me metodën e prodhimit, e përshtatur dhe e pa përshtatur sezonalisht
24. Llogaritë Rajonale
25. Bilanci i Pagesave tremujor
26. Pozicioni i Investimeve Ndërkombëtare
27. Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK)
28. Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)
29. Matja Fuqisë Blerëse (MFB)

### **Rezultatet e arrira**

1. Përbushja e detyrimeve për transmetimin e të dhënave sipas kërkesave të Programit të Transmetimit ESA 2010.
2. Përmirësimi i kapaciteteve njerëzore nëpërmjet pjesëmarrjes në seminare, kurse trajnimi të ofruara nga institucione kombëtare e ndërkombëtare dhe vizita pune në institucione homologe.
3. Klasifikimi i njësive institucionale në sektorë institucionalë, duke u grupuar në:
  - a. Njësitë jo-financiare
  - b. Njësitë Financiare
  - c. Qeveria
  - d. Familjet
  - e. Institucionet jo-fitimprurëse në shërbim të familjeve
4. Tregues përkatës të Llogarisë së Prodhimit të vlerësuar sipas sektorëve Institucionalë: Prodhimi (tregtar, për përdorim vetjak, prodhim jotregtar), Konsumi Ndërmjetës, Taksat mbi produktet, Subvencionet mbi produktet dhe Vlera e Shtuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

5. Vlerësime të bëra me çmime korrente.
6. Rritja e mbulimit të sektorit të korporatave financiare dhe përfrimi i statistikave monetare me kërkesat e Bankës Qendore Europiane.
7. PBB e publikuar sipas metodës së prodhimit në A10 degët kryesore të ekonomisë, me çmime korrente dhe konstante, të përshtatura dhe jo nga efektet sezonale.
8. Publikimi i komponentëve kryesorë të PBB-së sipas shpenzimeve me çmime korrente dhe konstante.
9. Vlerësimi dhe publikimi i komponentëve kryesorë të PBB-së me metodën e shpenzimeve të përshtatura sezonalisht, me çmime korrente dhe konstante.
10. PBB e publikuar sipas metodës së prodhimit në A10 degët kryesore të ekonomisë, me çmime korrente dhe konstante, të përshtatura dhe jo nga efektet sezonale.
11. Tregues rajonalë të vlerësuar duke përdorur të dhënat e Census-AI 2011.
12. PBB e vlerësuar sipas rajoneve statistikore, niveli 2 dhe 3, dhe degëve kryesore të ekonomisë në seri kohore.
13. PBB e vlerësuar për frymë sipas rajoneve statistikore, niveli 2 dhe 3, si dhe të shprehura në termat e Paritetit të Fuqisë Blerëse (PPS).
14. Tregues statistikorë të bilancit të pagesave të detajuar sipas ndarjes gjeografike dhe sektorëve institucionalë, tregues statistikorë të pozicionit të investimeve ndërkombëtare me frekuencë tremujore.
15. Indeksi mujor i Çmimeve të Konsumit sipas hierarkisë së mëposhtme:
  - a. Indeksi Total
  - b. Indeksi sipas grup-mallrave
  - c. Indeksi sipas grup-mallrave
  - d. Indeksi në nivel të detajuar sipas artikujve
16. Ndryshimi vjetor dhe mesatar vjetor i Çmimeve të Konsumit.
17. Ndryshimi mujor i Çmimeve të Konsumit.
18. Lista e përditësuar e njësiive tregtare në periudha vjetore.
19. Shporta e përditësuar e produkteve me përshkrimet përkatëse në periudha vjetore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

20. Peshat e përditësuara të produkteve në periudha vjetore.
21. Shporta e produkteve për pensionistët.
22. Indeksi mujor i Çmimeve të Harmonizuara të Konsumit sipas hierarkisë së mëposhtme:
  - a. Indeksi Total
  - b. Indeksi sipas grupeve kryesore
  - c. Indeksi sipas grup-mallrave
  - d. Indeksi në nivel 5-shifror
23. Indeksi Mujor i Çmimeve të Harmonizuara të Konsumit.
24. Ndryshimi mujor i Çmimeve të Harmonizuara të Konsumit.
25. Ndryshimi vjetor dhe mesatar vjetor i Çmimeve të Harmonizuara të Konsumit.
26. Lista e përditësuar e njësisve tregtare në periudha vjetore.
27. Shporta e përditësuar e produkteve me përshkrimet përkatëse në periudha vjetore.
28. Peshat e përditësuara të produkteve në periudha vjetore.
29. Prodhimi i Brendshëm Bruto, (PBB) për frymë në Fuqi Blerëse (PPPs).
30. Konsumi për frymë.
31. Indeksi i nivelit të çmimeve.
32. Inventari i burimeve të informacionit.
33. Burimi kryesor i përcaktuar.

### **Aktivitete të perealizuara**

Aktiviteti **04011616** **Normat e interesit për depozitat dhe huatë e reja / dhe gjendje në fund të periudhës** nuk është realizuar pasi bazuar në rregulloren nr. 48, datë: 6.9.2017, “Për raportimet në Bankën e Shqipërisë të Statistikave të normave të interesit”, raportimi për bllokun i ri statistikor për normat e interesit (mbi sasi të gjendje dhe sasi të reja) do të fillojë në muajin Janar, 2019 për periudhën referencë Dhjetor 2017. Gjatë vitit 2018 është parashikuar mbledhja, testimi dhe kontrolli i informacionit statistikor. Publikimi i serisë 1-



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

vjeçare (Dhjetor 2017 - Dhjetor 2018) të statistikave të normave të interesit do të behet fillim të vitit 2019.

### **- Fusha prioritare 05: Qëndrueshmëria e mjedisit**

Kjo fushë mbulon prodhimin e indikatorëve dhe statistikave mbi llogaritë monetare dhe fizike mjedisore.

- Objektivi i kësaj fushe është prodhimi i indikatorëve dhe statistikave me bazë vjetore mbi llogaritë ekonomike dhe fizike në mjedis si dhe përmirësimi i cilësisë statistikore për llogaritë fizike në mjedis.

Agjencitë statistikore përgjegjëse: INSTAT.

### **- Fusha prioritare 06: Statistikat e Ndërmarrjeve Ekonomike**

Kjo fushë prioritare mbulon prodhimin e statistikave strukturore dhe afatshkurtra të ndërmarrjeve, statistikave FATS, të produkteve të industrisë përpunuese, turizmit, tregtisë së jashtme të mallrave dhe shërbimeve si dhe prodhimin e statistikave mbi kërkim zhvillimin dhe inovacionin.

- Objektivi i kësaj fushe prioritare është përmirësimi i cilësisë së të dhënave strukturore të ndërmarrjeve si dhe prodhimi i treguesve cilësorë në kuadër të prodhimit të të dhënave afatshkurtra mbi to; prodhimi i të dhënave cilësore mbi mallrat e industrisë përpunuese, FATS, turizmin si dhe prodhimi i të dhënave mbi kërkim zhvillimin dhe inovacionin në përputhje me standartet ndërkombëtare.

Agjencitë statistikore përgjegjëse: INSTAT, Banka e Shqipërisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

**Aktivitete statistikore të realizuara**

1. Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve (SSN)
2. Produkte të Industrisë Përpunuese
3. Statistikat tremujore të ndërmarrjeve
4. Çmimet në industri dhe ndërtim
5. Lejet e ndërtimit të miratuara
6. Tregtia e Jashtme e Mallrave
7. Statistika mbi përdorimin e Teknologjisë së Inforamcionit dhe Komunikimit në Shqipëri

**Rezultatet e arrira**

1. Indeksi i shitjeve neto në vlerë dhe në volum (si rezultat i deflatimit me indeksin e çmimeve) për aktivitetet e mbuluara në vrojtimin tremujor.
2. Indeksi i prodhimit në vlerë dhe në volum (si rezultat i deflatimit me indeksin e çmimeve) në Industri dhe Ndërtim.
3. Indeksi i punësimit.
4. Indeksi i pagave.
5. Indekset e Çmimeve të Prodhimit, Eksportit, Importit dhe Shërbimeve sipas aktiviteteve ekonomike.
6. Indekset e Kushtimit në Ndërtim (banesa, punime inxhinierie dhe gjithsej).
7. Deflatorët përkatës për çdo aktivitet të mbuluar në anketë.
8. Tregues për lejet e ndërtimit në numër, sipërfaqe, vlerë e parashikuar sipas llojeve të ndërtimit, në nivel bashkie, qarku dhe vendi.
9. Tregues për lejet e ndërtimit sipas llojit dhe klientit.
10. Tregues statistikorë të investimeve të huaja të detajuara, me mbulim të plotë sipas standardeve ndërkombëtare.
11. Statistika të tregtisë së jashtme në periudha mujore, tremujore, vjetore sipas grup mallrave.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

12. Statistika të tregtisë së jashtme të mallrave, importet dhe eksportet sipas grup mallrave.
13. Statistika të tregtisë së jashtme të mallrave, importet dhe eksportet sipas shteteve.
14. Statistika të tregtisë së jashtme të mallrave, importet dhe eksportet sipas karakteristikave të ndërmarrjeve.
15. Statistika të tregtisë së jashtme të mallrave, importet dhe eksportet sipas mënyrave të transportit.
16. Tregues statistikorë mbi nivelin e përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në ndërmarrje.

## - Fusha prioritare 07 Njerëzit e Evropës

Kjo fushë prioritare mbulon prodhimin e të dhënave mbi: demografinë, migracionin, censusin, punësimin dhe papunësinë, kostot dhe të ardhurat nga puna, gjininë dhe diskriminin, të ardhurat dhe nivelin e jetesës, arsimin, trajnimin profesional dhe të mësuarin gjatë gjithë jetës, kulturën dhe rininë, mbrojtjen sociale dhe shëndetin publik.

- Objektivi i kësaj fushe prioritare është prodhimi i statistikave demografike cilësore në nivel kombëtar dhe rajonal, përmirësimi i burimit të të dhënave mbi migracionin, fëmijët dhe moshimin si dhe realizimi në përputhje të plotë me standartet e Eurostat i censusit të popullsisë dhe banesave 2021 dhe vrojttimeve statistikore: ABF (Anketa e Buxhetit të Familjes), AKP (Anketa e Kostove të Punës), APK (Anketa e Përdorimit të Kohës), EU-SILC (Anketa mbi të Ardhurat dhe Nivelin e Jetesës) dhe AES (Anketa e Edukimit të të Rriturve).

Angjencitë statistikore përgjegjëse: INSTAT.

### Aktivitetet statistikore të realizuara

1. Popullsia



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

2. Lindjet e gjalla
3. Martesat
4. Vdekjet mbi një Vjeç
5. Vdekjet foshnjore
6. Koeficiente kryesore demografike
7. Integrimi i migrantëve, Lejet e qëndrimit, Azilet
8. Popullsia ekonomikisht aktive (Forca e punës)
9. Punësimi
10. Papunësia sipas Anketës së Forcave të Punës
11. Papunësia e regjistruar
12. Kostot e punës
13. Të dhëna administrative mbi pagat
14. Tregues gjinore ne arsim
15. Tregues gjinor ne punesim
16. Tregues gjinor per te ardhurat
17. Pjesëmarrja e gruas në vendimarrje dhe biznesi
18. Tregues gjinor per shendetin
19. Tregues gjinor te tjere
20. Krimet dhe zbulimi i tyre
21. Autoret e veprave penale
22. Të dëmtuarit nga veprat penale
23. Të dënuarit
24. Të burgosurit
25. Dhuna ne familje
26. Arsimi profesional dhe Të mësuarit gjatë gjithë jetës (LLL)
27. Të dhëna administrative mbi statistikat e kulturës
28. Kujdesi primar shëndetësor dhe shëndeti publik
29. Sëmundshmëria spitalore dhe aktiviteti i institucioneve shëndetësore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

30. Shkaqet e vdekjeve sipas skedës për vdekjet mbi një vjeç
31. Shkaqet e vdekjeve për vdekjet e fëmijëve nën 1 vjeç
32. Koeficientet kryesore shëndetësore (SDG)
33. Mbrojtja Sociale
34. Mbledhja e treguesve ekzistues të mbrojtjes sociale
35. Mbledhja e të dhënave sasiore të Modullit mbi Numrin e Përfituesve të Pensioneve

### **Rezultatet e arrira**

1. Azilkërkuesit sipas vendeve të origjinës.
2. Azilkërkuesit sipas arsyes.
3. Azil-kërkuesit sipas moshës dhe gjinisë.
4. Vendimi mbi aplikimin për azil.
5. Anketë tremujore e forcave të punës, e konsoliduar, lidhur me cilësinë e të dhënave të mbledhura.
6. Anketë tremujore e forcave të punës, e konsoliduar, lidhur me cilësinë e të dhënave të mbledhura.
7. Gamë më e gjerë treguesish statistikore gjinore në të gjitha fushat.
8. Rritje e numrit të treguesve gjinore në fushën e popullsisë duke paraqitur në mënyrë sa më të detajuar dinamikat e saj në kuadër të aspektit gjinor.
9. Tregues gjinorë në fushën e arsimit duke synuar matjen e përfshirjes në arsim nga djemtë dhe vajzat në të gjitha ciklet arsimore.
10. Tregues gjinorë në fushën e punësimit duke analizuar tendencën e punësimit të burrave dhe grave si dhe dinamikat e tyre në tregun e punës.
11. Tregues gjinorë në aspektin e të ardhurave, duke tentuar në paraqitjen e situatës së varfërisë në aspektin gjinor.
12. Tregues gjinorë në fushën e vendimmarjes.
13. Tregues gjinorë në fushën e shëndetësisë, duke analizuar jetëgjatësinë e burrave dhe grave si dhe duke tentuar për të parë më thellë jetën cilësore të tyre.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

14. Tregues gjinorë të përbërë në përputhje me rekomandimet ndërkombëtare si dhe metodologji e harmonizuar me standardet e Eurostat-it për treguesit e treguesve gjinorë.
15. Analiza longitudinale dhe cross-section i të dhënave të anketës SILC.
16. Ndërtimi i një strukture bazë sipas Eurostat për mbulimin e të gjithë hapave të anketës.
17. Kampion i përditësuar tregues të matur të saktësisë.
18. Gamë e përditësuar e indikatorëve nëpërmjet rishikimit të pyetësorit dhe manualit.
19. Statistika mbi krimet dhe shkalla e zbulimit të tyre.
20. Koeficienti i kriminalitetit (vepra penale në total).
21. Koeficientë lidhur me vepra specifike penale (vrasje, vjedhje, vjedhje automjetesh etj).
22. Statistika mbi personat në konflikt me ligjin.
23. Koeficientë lidhur me personelin e sistemit të Drejtësisë (oficer policie, prokuror, gjyqëtar dhe magjistratë).
24. Statistika mbi normën e të burgosurve dhe të paraburgosurve të mbajtur në burgje.
25. Tregues ndërkombëtarë lidhur me të miturit.
26. Nënshkrimi i një memorandumi mirëkupimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.
27. Statistika mbi tregues të arsimit në të gjitha nivelet.
28. Prodhimi i treguesve të kutlurës bazuar në të dhënat administrative që vijnë nga Ministria e Kulturës dhe institucionet e varësisë.
29. Përmirësimi i statistikave aktuale të mbrojtjes sociale.

### **Aktivitete të porealizuara**

Aktiviteti **0701210106 Divorcet** nuk është realizuar për shkak të dërgimit me vonesë të të dhënave nga Ministria e drejtësisë pasi te dhënat vijnë në INSTAT vetëm pasi publikohet vjetari i tyre dhe për këtë të fundit nuk ka një kalendar publikimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

## **- Fusha prioritare 08: Statistikat Sektoriale, Bujqësore dhe Mjedisore e Gjeohapësinore**

Kjo fushë prioritare mbulon prodhimin e të dhënave mbi: ndërmarrjet dhe turizmin në nivel rajonal, infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeo-hapsinor, mbetjet dhe substancat e rrezikshme, ujërat, pylltarinë dhe bio-diversitetin, energjinë, transportin, bujqësinë, prodhimet organike, përdorimin e tokës, blegtorinë, peshkimin, agromjedisin.

- Objektivi i kësaj fushe prioritare është hartimi dhe publikimi i harmonizuar dhe me cilësi i statistikave të ndërmarrjeve dhe turizmit në nivel rajonal, prodhimi në kohë dhe cilësi i të dhënave mbi mbetjet, ujërat, kullotat, biodiversitetin, transportin produktet bimore, peshkimin, madhësinë e tokës bujqësore në përdorim si dhe përgatitja e legjislacionit mbi pesticidet, të gjitha në harmoni me kërkesat dhe standartet e BE-së.

Agjencitë statistikore përgjegjëse: INSTAT.

### **Aktivitete statistikore të realizuara**

1. Statistikat rajonale të ndërmarrjeve
2. Hartimi dhe miratimi i standardeve të layers "Demografia" në bashkëpunim me ASIG (sipas planifikimit 5 vjeçar të ASIG-ut)
3. Statistikat e energjisë – Prodhimi
4. Statistikat e transportit – Hekurudhor
5. Statistikat e transportit – Detar
6. Statistikat e transportit - Ajror
7. Statistikat e transportit – Rajonale
8. Statistikat e aksidenteve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

**Rezultatet e arrira**

1. Regjistri i Ndërmarrjeve dhe Regjistri i Njësive Lokale, i përditësuar.
2. Lista e fushave (ndryshoreve) mbi bazën e të cilave do të llogariten treguesit e rajonal të ndërmarrjeve.
3. Informacion i detajuar mbi pyjet, kullotat, gjuetinë dhe ekosistemet në nivel Qarku, Rajonal dhe Kombëtar.
4. Të dhëna cilësore kadastrale të fondit për pyjet, kullotat dhe kundërvajtjet në pyje.
5. Të dhëna cilësore mbi speciet e rrezikuara dhe ato të mbrojtura për (florën dhe faunën) dhe të dhëna më të plota për numrin dhe sipërfaqen e zonave të mbrojtura.
6. Struktura dhe bilancet në pyje e kullota si dhe bilanci burim-përdorim i produkteve pyjore.
7. Prodhimi i Bilancit të energjisë elektrike në publikimin specifik me periodicitet tremujor "Bilanci i energjisë elektrike".
8. Treguesit në volum mbi infrastrukturën e rrjetit.
9. Statistika e transportit sipas llojeve.
10. Inventari i mjeteve.
11. Aksidentet.
12. Regjistër statistikor i mjeteve.
13. Tregues statistikor mbi transportin hekurudhor të mallrave në njësi fizike dhe ton/km.
14. Tregues statistikor mbi transportin hekurudhor të pasagjerëve në numër dhe pasagjerë/km.
15. Tregues statistikor mbi transportin hekurudhor ndërkombëtar të mallrave në njësi fizike dhe për ton/km.
16. Tregues statistikorë mbi aksidentet dhe numrin personave të aksidentuar në transportin hekurudhor.
17. Tregues statistikor mbi transportin detar të mallrave në njësi fizike.
18. Tregues statistikor mbi transportin detar të pasagjerëve në numër.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

19. Tregues statistikor numrin e anijeve të hyra dhe të dala nga portet shqiptare.
20. Tregues statistikorë mbi volumin e mallrave të hyra dhe të dala sipas llojit të mallit.
21. Numri i kompanive ajrore.
22. Numri i fluturimeve ajrore.
23. Numri i mbikalimeve.
24. Tregues statistikor mbi transportin ajror të pasagjerëve në numër.
25. Numri i mjeteve rrugore sipas rajoneve, për mallra dhe pasagjerë.
26. Numri i aksidenteve dhe numri i personave të aksidentuar sipas rajoneve.
27. Numri i aksidenteve dhe numri i personave të aksidentuar.
28. Tregues statistikorë si sipërfaqe, prodhim, rendiment dhe përmbajtje lagështie për drithërat dhe bishtajoret me periodicitet vjetor.
29. Tregues statistikorë si sipërfaqe, prodhim dhe rendiment për bimët e tjera të mbjella në tokë arë, me periodicitet vjetor.
30. Tregues statistikorë si sipërfaqe, prodhim dhe rendiment për pemët frutore, vreshtat, agrumet dhe ullirin me periodicitet vjetor.
31. Struktura e blegtorisë sipas llojeve: gjedhë, të leshta dhe të dhirta, derra.
32. Struktura shpendëve.
33. Prodhimi i mishit sipas llojeve: gjedhë, derra, të imta dhe shpendë.
34. Numri i kafshë të therura gjatë vitit në thertore sipas llojeve: gjedhë, të leshta dhe të dhirta, derra dhe kategoritë statistikore të therjeve, pesha e gjallë totale dhe pesha e therur totale sipas llojeve të kafshëve.
35. Prodhimi mujor i vezëve për treg.
36. Sasia e qumështit të lopës sipas përmbajtjes së yndyrës dhe proteinave që shesin fermerët direkt në fabrikat përpunuese të qumështit gjatë muajit.
37. Sasia e qumështit të lopës, deles dhe dhive që shesin fermerët direkt në fabrikat përpunuese të qumështit gjatë vitit.
38. Sasia e produkteve të qumështit sipas llojeve (djathë, gjalpë, kos, gjizë) që prodhohet nga fabrikat dhe baxhot.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

39. Sasia e qumështit të prodhuar në fermë sipas llojeve: lope dele dhe dhie.
40. Statistika mbi llogaritë ekonomike bujqësore me periodicitet tremujor.
41. Indeksi i çmimeve të produkteve bujqësore.
42. Çmimet absolute të llogaritura.
43. Koncepte dhe definicione të statistikave të peshkimit detar të zbatuara në përputhje me kërkesat e BE sipas Manualit të Statistikave të Peshkimit të rekomanduar nga FAO.
44. Statistika të akuakulturës dhe molusqeve, të prodhuara në përputhje me Rregulloren Nr. 762/2008/KE.
45. Rezultate të publikuara mbi mbulimin dhe përdorimin e tokës.
46. Rezultate të publikuara mbi tokën e punueshme, livadhet dhe kullotat, tokën e zënë me pemëtore (pemë frutore, ullinj, agrume dhe vreshta) dhe tokë tjetër jo-bujqësore.

## **- Fusha prioritare 11: Statistikat Shumëqëllimore dhe Efienca e Fituar në Prodhim**

Kjo fushë prioritare mbulon koordinimin për konfidencialitetin statistikor dhe aksesin në mikrodata dhe gjithashtu standardizimin statistikor të të dhënave dhe metadatave duke përfshirë klasifikimet, cilësinë statistikore, regjistrat statistikorë të njësive ekonomike dhe përdorimin e standardit GSBPM në zbatimin e aktiviteteve statistikore.

- Objektivi i kësaj fushe prioritare është përafrimi i kuadrit ligjor për përcaktimin e kufijve për mbrojtjen e të dhënave konfidenciale sipas standardeve të kërkuara evropiane për mbrojtjen e të dhënave konfidenciale, metodologjinë për sigurimin e konfidencialitetit statistikor dhe zhvillimi i mjeteve për mbrojtjen e të dhënave mikro apo tabulare.

Agjencitë statistikore përgjegjëse: INSTAT.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

### **Aktivitetet statistikore të realizuara**

1. Standardizimi statistikor i të dhënave dhe metadatave
2. Aplikimi i Generic Statistical Business Process Model (GSBPM)
3. Cilësia Statistikore
4. Regjistrat e njësive ekonomike
5. Klasifikimet për statistikat e tregtisë së mallrave
6. Mbrojtja e të dhënave

### **Rezultatet e arrira**

1. Publikimi në faqen e web-it të INSTAT i raporteve të metadata-ve sipas fushave të prodhimit statistikor.
2. Dokumentimi i 5 produkteve statistikore.
3. Prodhimi i raporteve të metadatave nepermjet sistemit IMS të implementuar.
4. Ndjekja dhe identifikimi i problematikave të proceseve të prodhimit statistikor sipas modelit GSBPM.
5. Publikimi i rezultateve në faqen e Webit të INSTAT.
6. Prodhimi i 7 ESMS dhe 1 ESQRS.
7. Regjistra statistikorë të njësive ekonomike, të përditësuar e cilësorë, sipas rekomandimeve të BE-së dhe kërkesave të brendshme.
8. Statistika zyrtare cilësore dhe në kohë të prodhuar nga regjistrat e njësive ekonomike sipas treguesve identifikues, demografikë dhe ekonomikë.
9. Adresa të përditësuara dhe të kodifikuara sipas koordinatave gjeografike për bashkitë sipas sistemit GIS.
10. Statistika zyrtare cilësore dhe në kohë të prodhuar nga regjistrat e ndërmarrjeve shumëkombëshe sipas treguesve identifikues, demografikë dhe ekonomikë.
11. Statistika të tregtisë së jashtme sipas klasifikimit të përditësuar të mallrave.



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE